VENDIM
Nr.59, datë 29.10.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OST SHA PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 2008-2010

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", pika 9.2, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2007, pasi shqyrtoi aplikimin për llogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për periudhën 2008-2010,

VENDOSI:

Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për llogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për periudhën 2008-2010.

Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta